

POLICY BRIEF

**Standardet e aksesueshmërisë
për personat me aftësi të kufizuara
në ndërhyrjet infrastrukturore
të 2015-2016 të Bashkisë Tiranë**

Suela Lala

Përmbledhje ekzekutive

Në kuadër të një viti (2015-2016), Bashkia e Tiranës ka ndërmarrë disa ndërhyrje infrastrukturore për përmirësimin e rrugëve dhe trotuarëve, parqeve dhe hapësirave publike, stacioneve të autobusit dhe hapësiravetë rezervuara për parkim. Megjithatë, në shumicën e rasteve këto ndërhyrje nuk kanë qenë në përputhje me standardet e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, duke mos kontribuar në pjesëmarrjen në jetën në komunitet të këtyre personave. Përkundër vullnetit të mirë, Bashkia e Tiranës ka një rrugë të gjatë përpara për të siguruar aksesin për personat me aftësi të kufizuara. Pjesë e rekomandimeve të këtij policy brief është blikëqyrja më e mirë e punimeve që po kryhen dhe shpërndarja më e mirë e informacionit mbi standardet e aksesueshmërisë për të gjitha palët e interesuara. Më e rëndësishmja, asnjë akses i vërtet nuk do të mundësohet pa pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha proceset e planifikimit.

Vizioni i një qyteti të aksesueshëm, ende në luftë me standardet

Censusi i fundit i mbajtur në Shqipëri në vitin 2011¹ identifikoi për herë të parë që 6.2% e popullsisë mbi 15 vjeç, ose një total prej 137,435 personash, kanë ndonjë formë aftësie të kufizuar (shikimi, dëgjimi, lëvizshmëria, njohje, vetkujdesi dhe komunikimi). Megjithatë, organizatat për aftësinë e kufizuar vlerësojnë se përqindja e personave me aftësi të kufizuar mund të jetë më e lartë, duke patur parasysh se shumë individë hezitojnë të vetidentifikohen si persona me aftësi të kufizuara. Ekziston gjithashtu një keqkuptim rreth cilit grup i përkasin, sipas përkufizimit të aftësisë së kufizuar. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, rreth 15% e popullsisë botërore ka ndonjë formë aftësie të kufizuar.²

Tirana, duke qenë kryeqyteti i Shqipërisë, ku

jeton pothuajse 1/3 e popullsisë totale, vazhdon të jetë qytet i cili nuk i lejon personave me aftësi të kufizuar të gëzojnë të drejtat e tyre të plota dhe të marrin pjesë në jetën në komunitet, pavarësisht ndërhyrjeve të fundit në infrastrukturën urbane. Sipas Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara³, aksesueshmëria është një parakusht për gëzimin e të gjitha të drejtave të tjera nga personat me aftësi të kufizuara.

Ky policy brief analizon statusin e ndërhyrjeve në infrastrukturë të zhvilluara nga Bashkia e Tiranës gjatë periudhës 2015-2016, për sa i përket standardeve të aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara. Punimi përshkruan shkurtimisht kuadrin ligjor në lidhje me aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara dhe më pas vazhdon me analizën nëse këto standarde janë përmbushur në kategori të caktuara të ndërhyrjeve, si për shembull hapësirat e rezervuara për parkim, stacionet e autobusit, trotuarët, parqet dhe hapësirat publike, si dhe aksesin në informacion dhe komunikim. Dokumenti arrin në përfundimin se ndërhyrjet e reja infrastrukturore të kryera në periudhën 2015-2016 shpesh nuk kanë standardet e aksesueshmërisë ose injorojnë tërësisht nevojat specifike të qytetarëve. Së fundmi, janë dhënë disa rekomandime që mund të jenë të dobishme në mënyrë që bashkia të përmirësojë performancën e saj në dhënie të shërbimeve, të cilat duhet të përfshihen nga të gjithë qytetarët, përfshirë personat me aftësi të kufizuara.

Tirana ka potencialin dhe duhet të bëhet model i përmbushjes së standardeve të aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara. Kjo më pas duhet të shërbejë si një model pozitiv për qytetet e tjera në të gjithë Shqipërinë.

Kuadri ligjor për personat me aftësi të kufizuara dhe aksesueshmërinë

Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara u ratifikua nga Parlamenti shqiptar në 15 nëntor 2012⁴, çka do të thotë se dispozitat e Konventës janë ligjërisht të detyrueshme. Sipas Konventës, aksesueshmëria është parim i përgjithshëm, si dhe nen më vete⁵. Përveç saj, shumë prej neneve të tjera që përmbajnë dispozita mbi arsimin, punësimin, jetesën e pavarur, aksesin në drejtësi, etj., i referohen nevojës për aksesueshmëri. Është e qartë se aksesueshmëria nuk është vetëm një e drejtë për personat me aftësi të kufizuar, por një parakusht primar për gëzimin e të gjitha të drejtave të tjera.

Shqipëria ka vazhduar të përmirësojë legjislacionin e saj, në sajë edhe të Konventës, dhe miratoi Ligjin nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”. Termi “aksesueshmëri”⁶ përkufizohet si mënjanimi i pengesave të të gjitha llojeve. Ky ligj përcakton si një nga objektivat e tij identifikimin e përgjegjësive për agjencitë publike qëndrore dhe lokale në garantimin e parimeve të përfshirjes dhe aksesueshmërisë, me qëllimin final minimizimin deri në eliminim të barrierave për personat me aftësi të kufizuara për të siguruar pjesëmarrjen e tyre të barabartë dhe të plotë në shoqëri. Ligji parashikon që institucionet publike qëndrore dhe lokale duhet të marrin gradualisht masa për të hequr pengesat dhe gjithashtu të hartojnë një buxhet për ndërhyrjet.

Për të shpjeguar më mirë dispozitat e këtij ligji, një akt nënligjor u miratua me Vendim të Këshillit të Ministrave, nr. 1074, datë 23.12.2015, “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”. Ky akt nënligjor përcakton se autoritetet lokale dhe qëndrore, brenda gjashtë muajve nga ky vendim,⁷ duhet të hartojnë një plan mbi objektet dhe shërbimet, në kuadër të kompetencave të tyre, që duhet të bëhen të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara, buxhetine

alokuar për ndërhyrjet graduale dhe afatin kohor për kryerjen e këtyre punimeve.

Gjithashtu, asnjë ndërhyrje në infrastrukturë nuk duhet të financohet nëse nuk respekton standardet e aksesueshmërisë të parashikuara në rregulloren teknike, e cila u miratua me Vendim të Këshillit të Ministrave, nr. 1503, 19.11.2008, “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar”. Në fakt kjo rregullore siguron të gjitha standardet e nevojshme teknike që duhet të përmbushen për të pasur aksesueshmëri nga personat me aftësi të kufizuar për të përdorur infrastrukturën dhe shërbimet publike në baza të barabarta me qytetarët e tjerë, si dhe më e rëndësishmja, në mënyrë të sigurt dhe të lehtë.

Ekzistojnë akte të tjera ligjore të cilat u bashkëngjiten thirrjes për të garantuar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara. Një prej këtyre akteve është Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”. Ky akt mbron nga diskriminimi mbi një bazë të gjerë, përfshirë dhe aftësinë e kufizuar. Ai i kërkon subjekteve publike dhe private të mos diskriminojnë në bazë të aftësisë së kufizuar dhëmohimi i akomodimit të përshtatshëm⁸ konsiderohet diskriminim.

Aksesueshmëria në Bashkinë e Tiranës

Z. Erion Veliaj u zgjodh Kryebashkiak i Tiranës më 21 qershor 2015 dhe është në krye të bashkisë nga 30 korriku 2015. Në kohën kur ne jemi duke bërë këtë vlerësim, ai ka përfunduar vitin e parë të mandatit të tij. Megjithatë, duke ardhur nga pozicioni i tij i mëparshëm si Ministër i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, ai artikuloi shpesh në shfaqjet publike angazhimin dhe përkushtimin e tij për ta bërë Tiranën një qytet të aksesueshëm për të gjithë.

Gjatë këtij viti të parë, ai ka ndërmarrë disa nisma për ndërhyrje të reja në përmbushjen e standardeve teknike të aksesueshmërisë apo për të bërë të aksesueshëm ato trotuarë dhe ndërtesa që nuk ishin të aksesueshme më parë. Pavarësisht vullnetit të tij të mirë, paratë publike janë shpenzuar por fatkeqësisht stan-

dardet teknike, siç parashikohet në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1503, nuk janë respektuar ende. Gjithashtu, Bashkia e Tiranës nuk ka hartuar ende një plan se cilat objekte dhe shërbime në kuadër të kompetencave të saj do të bëhen të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara, buxhetine nevojshëm për këto ndërhyrje dhe afatin për zbatimin e tyre, edhe pse afati gjashtë mujor i parashikuar nga Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1074, ka kaluar tashmë.

Si pjesë e këtij policy brief, janë analizuar **20 ndërhyrje të reja** të bëra nga Bashkia e Tiranës që prej ardhjes së Z. Veliaj në krye të saj. Ndërhyrjet përfshijnë trotuarë, hapësira publike, hapësira të rezervuara për parkim për personat me aftësi të kufizuara, stacione autobusi, etj. Ndërhyrjet në rrugë dhe trotuarë të ndërmarrë gjatë vitit, të cilët u analizuan përfshijnë: Rruga Dritan Hoxha, Unaza e Vogël, Rruga e Durrësit, Rruga Androniqi Zengo Antoni (Laprakë), Rruga Piro Goda (Kombinat), rruga e re në krah të Pallatit të Kongreseve, rruga pas Postës Qëndrore, rruga pas Shallvareve, Rruga e Çamëve, Rruga Gjin Bue Shpata, Rruga Isuf Balta, Rruga e Barrikadave, Rruga Mine Peza dhe Rruga 5 Maji.

Hapësirat e rezervuara për parkim për personat me aftësi të kufizuara

Kjo është ndoshta zona ku progresi është më i dukshëm gjatë vitit të fundit. Ai nisime 2 hapësira të rezervuara për parkim për personat me aftësi të kufizuara nëvendparkimin bashkiak në Sheshin Italia dhe kjo praktikë e mirë u replikua më tej në rrugët e tjera kryesore të Tiranës si Myslym Shyri dhe Rruga e Barrikadave.

Sishënim pozitive duhet përmendurfakti se Policia Bashkiake bën një punë shumë të mirë në ruajtjen e hapësirave të rezervuara për parkim për përdorimin ekskluziv nga personat me aftësi të kufizuara. Gjithsesi, hapësirat e rezervuara për parkim janë ende shumë të pakta në numër për të sjellë një ndryshim të rëndësishëm në lëvizjen e personave me aftësi të kufizuara, të cilët përdorin makinat jo si një objekt luksi por si alternativën e vetme,

për shkak të mungesës së transportit publik të aksesueshëm. Sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1503,⁹ 5% e vendeve të parkimit duhet të rezervohen për personat me aftësi të kufizuara dhe në çdo rast jo më pak se një.

Përveç pamjaftueshmërisë së hapësirave të rezervuara për parkim për personat me aftësi të kufizuara, një problem tjetër është projektimi i këtyre hapësirave të parkimit jo brenda standardeve të parashikuara në rregulloren teknike të përmendur më lartë. Sipas nenit 12 të rregullores teknike, hapësirat e rezervuara për parkim duhet të jenë 6m në gjatësi dhe kur ka hapësira të shumta paralele parkimi, duhet të ketë hapësirë shtesë mes vendit të rezervuar të parkimit dhe të tjerave. Standardi teknik shpjegohet edhe me ilustrime nga vetë rregullorja.



Foto 1: Parkimi bashkiak tek Sheshi Italia

Fig. 33. - Vendi i parkimit me hapësirë në mes

Dalja nga parkingu në rrugën e këmbësorëve




Foto 2: Marrë nga rregullorja teknike, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 1503

Stacionet e autobusit dhe autobusat

Një tjetër ndërhyrje që Bashkia e Tiranës ka ndërmarrë gjatë së njëjtës periudhë është vendosja e stacioneve të reja të autobusëve në disa rrugë të Tiranës, përfshirë Rrugën Dritan Hoxha, Rrugën e Durrësit, Unazën e Vogël, etj.

Edhe pse stacionet e reja të autobusëve duken të zbuluar dhe modern, mënyra se si janë vendosur nuk lejon aksesin për personat me aftësi të kufizuara fizike. Ata janë praktikisht të mbyllur në të tre anët dhe nuk ka mundësi as për nënat me karroca fëmijësh që të hyjnë dhe të presin autobusin. Ndërsa këto stacione të reja të autobusëve janë të pajisura mirë me stenda publicitare dhe kioska të vogla, ato nuk parashikojnë tabelat e itinerarit për të ndihmuar në orientimin e qytetarëve me dëmtime intelektuale dhe të dëgjimit.



Foto 3

Transporti publik në përgjithësi është shumë problematik dhe jo i aksesueshëm për personat me aftësi të kufizuara. Edhe pse disa prej autobusëve kanë një platformë të pjerrët, stafi nuk është zakonisht i prirur për ta hapur. Gjithashtu, autobusët e tejmbushur e bëjnë të pamundur përdorimin e tyre nga personat me aftësi të kufizuara. Stacionet e autobusëve jo vetëm që janë ndërtuar në mënyrë që të bëjnë aksesin për personat me aftësi të kufizuara të vështirë dhe të pasigurt, por gjithashtu në disa

raسته ata përbëjnë kërcënim. Brenda autobusit nuk ka tabela të itinerarit për të ndihmuar personat me dëmtime të dëgjimit dhe as sinjale zanore për të njoftuar mbërritjen në një vend të caktuar për personat me dëmtime pamore.

Është e qartë se stacionet e reja të autobusëve dhe sistemi i përgjithshëm ekzistues i transportit publik nuk janë të aksesueshëm për personat me aftësi të kufizuara dhe nuk përputhen as me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1503 dhe as me atë nr. 1074.

Trotuarët

Trotuarët janë ndoshta forma më e dukshme e mungesës së aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara në Tiranë. Kryetari i ri i Bashkisë, gjatë vitit të parë, ka ndërmarrë një numër investimesh që prekin rrugët dhe tro-

tuarët. Në disa raste, investimi kishte për qëllim rindërtimin e plotë, si në rastin e Unazës së Vogël dhe rrugës Dritan Hoxha, ndërsa në raste të tjera vetëm ndërhyrje të pjesshme, vetëm duke i bërë të aksesueshme, si në rastin e Rrugës së Durrësit. Gjithashtu, janë rindërtuar rrugët dhe trotuarët në zonat e reja urbane të Tiranës. Në të tria këto raste, zbatimi i standardeve të përcaktuara në Konventën e OKB-së dhe në ligj si dhe në Vendimin nr. 1503 nuk janë përmbushur.

Unë do t'i ndaja çështjet aktuale problematike me standardet e aksesueshmërisë në tre kategori: (1) rindërtimi i rrugëve në zonat e reja urbane; (2) rindërtimi në rrugët kryesore dhe trotuarët; dhe (3) ndërhyrje vetëm për t'i bërë trotuarët të aksesueshëm për personat me aftësi të kufizuara.

1. Rindërtimi i rrugëve në zonat e reja urbane

Këto ndërhyrje tregojnë luftën ekstreme me standardet dhe trotuarët, të cilët nuk janë vetëm të papërdorshëm nga personat me aftësi të kufizuara dhe prindërit me karroca fëmijësh, por edhe nga këmbësorët. Në këtë kategori bëjnë pjesë rruga Androniqi Zengo Antoni (Laprakë) dhe rruga Piro Goda (Kombinat), dhe gjithashtu disa rrugë në zemër të lagjeve në pjesën qendrore të qytetit. Këto trotuarë nuk përmbushin standardet minimale për t'u konsideruar në rradhë të parë trotuarë, duke lënë mënjanë elementët e aksesueshmërisë që mungojnë plotësisht.



Foto 4: Marrë nga llogaria zyrtare në Facebook e Z. Veliaj



Foto 5

Sipas nenit 7 të Vendimit nr. 1503, trotuarët duhet të jenë të paktën 1.2m të gjerë, duke përjashtuar pemët, sinjalistikën dhe ndriçimin.

2. Rindërtimi në rrugët kryesore dhe trotuarët

Bashkia e Tiranës ka ndërmarrë rindërtime të mëdha të disa rrugëve kryesore si rruga Dritan Hoxha, Unaza e Vogël, rruga 5 Maj dhe rruga e re pas Pallatit të Kongreseve dhe, sipas deklaratave të saj, është përpjekur të sjellë standardet me të mira të aksesueshmërisë. Gjithsesi, realiteti është krejt ndryshe. Rruga Dritan Hoxha ka probleme dhe jo kudo trotuarët janë të aksesueshëm dhe brenda standardeve për personat me aftësi të kufizuara. Nuk ka absolutisht elementë për personat me dëmtime të shikimit.



Foto 6

Fig. 39. – Ishulli për këmbësorë.




Foto 7: Marrë nga ilustrimet e rregullores teknike

Unaza e Vogël ka sjellë standardin më të mirë të aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara në lëvizje dhe është përpjekur të sjellë disa elementë për ata me dëmtime të shikimit. Sërisht këto elementë janë larg përmbytjes së standardeve teknike të përshkruara në Vendimin nr. 1503 dhe si pasojë janë të padobishëm.



Foto 8

Fig. 37. - Vendkalimi i këmbësorëve jashtë udhëkryqit.
Vija e udhëheqëse.




Foto 9: Marrë nga ilustrimet e rregullores teknike

Rruga pas Pallatit të Kongreseve është e pranueshme përse i përket aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara në lëvizje, por ajo nuk përfshin asnjë element për personat me dëmtime të shikimit. Rruga 5 Maji has tërësisht mungesën e elementeve të aksesueshmërisë. Asnjë semafor zanor nuk është i pranishëm në ndonjë nga këto rrugë.

3. Ndërrhyrje vetëm për t'i bërë trotuarët të aksesueshëm për personat me aftësi të kufizuara

Gjatë vitit të kaluar, ka pasur disa nisma nga stafi i bashkisë (në krahasim me kompanitë e kontraktuara) për përmirësimin e trotuarëve dhe bërjen e tyre të aksesueshëm si në Rrugën e Durrësit, në rrugën Mine Peza, në rrugën

Gjin Bue Shpata, etj.

Pavarësisht vullnetit të mirë, këto ndërhyrje nuk janë në përputhje me standardet dhe trotuarët nuk janë tërësisht të aksesueshëm për personat me aftësi të kufizuara. Në disa pjesë, ata janë shumë të pjerrtë, çka do të thotë që standardet nuk janë respektuar, në pjesë të tjera është ulur pjerrtësia por jo mjaftueshëm për ta bërë të aksesueshëm për përdoruesit e karrigeve me rrota dhe për prindërit me karroca fëmijësh, ndërsa në raste të tjera ndërhyrja është vetëm një korrigjim i thjeshtë i çastit i çfarë kishin bërë gabim më herët. Sërisht, asnjë element nuk është prezent për personat me dëmtime të shikimit.

Para publike dhe përpjekje janë shpenzuar, por pa garantuar akses real për personat me aftësi të kufizuara.




Foto 10



Foto 11

Parqe dhe hapësira publike

Përveç ndërhyrjeve në rrugë dhe trotuarë, në stacionët e rinj të autobusëve dhe nëhapësirat e rezervuara për parkim, gjatë vitit të kaluar, Bashkia e Tiranës ka ndërmarrë disa ndërhyrje në parqe të vogla/hapësira publike në brendësi të lagjeve. Do të përmendja hapësirën publike tek sheshi Karl Topia ose tek blloku Mine Peza. Ndonëse kjo nismë është për t'u përshëndetur, nuk janë marrë në konsideratë elementët e aksesueshmërisë për personat me aftësi të

kufizuara dhe dispozitat (neni 27) e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1503. Hapësirat publike në shumicën e rasteve nuk lidhen me rrugët pranë dhe trotuarët, duke mospërfshirë elementë të aksesueshmërisë. Dhe këtu i referohemi kryesisht platformave sepse mungon tërësisht përdorimi i sipërfaqeve me relief të prekshëm për paralajmërimin dhe gjetjene rrugës nga personat me dëmtime të shikimit.



Foto 12: Marrë nga faqja zyrtare në Facebook e Kryetarit të Bashkisë, Z. Veliaj

Aksesi në informacion dhe komunikim

Përsa i përket aksesit në informacion dhe komunikim situata është edhe me keq. Ekziston tani një vendim i Këshillit të Ministrave nr. 837, datë 03.12.2014, që njihet zyrtarisht gjuhën e shenjave. Deri më tani, Bashkia e Tiranës nuk ofron përkthimin në gjuhën e shenjave të asnjë prej shërbimeve të saj, ndonëse Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1074, në neni 12 e sanksionon këtë detyrim.

Faqja zyrtare e internetit e Bashkisë së Tiranës dhe ajo e Drejtorisë së Përgjithshme për Taksat dhe Tarifatat Vendore nuk janë të aksesueshme

nga personat me dëmtime të shikimit apo dëgjimit, ndonëse neni 8 parashikon se mjetet, mënyrat dhe format e përdorura për ofrimin e shërbimeve publike duhet të jenë në përputhje me kërkesat në aksesueshmërinë në komunikim sipas këtij vendimi.

Stacionët e autobusëve dhe vetë autobusët nuk kanë tabelat e itinetarëve për personat me dëmtime të dëgjimit dhe nuk ofrojnë informacione zanore për ata me dëmtime të shikimit.

Rekomandime

Bashkia e Tiranës ka ndërmarrë një seri ndërhyrjesh në infrastrukturë gjatëperiudhës 2015-2016. Gjithsesi, *këto ndërhyrje nuk garantojnë standardet e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara*. Bashkia ka shumë punë për të bërë nëpërkthimine vullnetit të saj të mirë në veprimevërtetë të prekshme që mundësojnë aksesueshmëri brenda standardeve dhe që janë të dobishme për personat me aftësi të kufizuara.

Bashkia e Tiranës duhet:

- Të mbikqyrë të gjitha punimet infrastrukturore që po kryen, me një fokus të veçantë në sigurimin e zbatimit të standardeve teknike të përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1503.
- Sipas motos së lëvizjes për aftësinë e kufizuar “asgjë për ne pa ne”, bashkia

duhet të përfshijë personat me aftësi të kufizuara në të gjitha proceset e ndërhyrjes që ndikojnë në jetën e tyre në komunitet. Këto do të zbatohen në veçanti në mbikqyrjen e punimeve që po kryhen ose gjatë hartimit të projekteve, në mënyrë që të sigurohet përfshirja e të gjithë elementëve të nevojshëm.

- Të sigurohet informacion dhe trajnim mbi standardet e aksesueshmërisë për stafin përkatës në bashki, në kompanitë projektuese, si dhe në kompanitë e kontraktuara që do të kryejnë punimet.
- Të sigurohet shqyrtimi i aksesueshmërisë për të gjitha ndërhyrjet.
- Të krijohet një mekanizëm ankesash i lehtë në përdorim për personat me aftësi të kufizuara për të adresuar problemet e aksesueshmërisë në të gjithë territorin e Bashkisë së Tiranës.

Shënime

- 1 Censusi i popullsisë dhe banesave 2011 (Gusht 2016) <http://www.instat.gov.al/en/census/census-2011.aspx>.
- 2 Organizata Botërore e Shëndetësisë, Raporti Botëror për Aftësinë e Kufizuar (Gjenevë 2011), http://www.who.int/disabilities/world_report/2011/en/
- 3 Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, <http://www.un.org/disabilities/convention/conventionfull.shtml>.
- 4 Ligji nr.108/2012, 15.11.2012, Për ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”.
- 5 Neni 9.
- 6 Ligjinr.93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, Neni 3.
- 7 Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”, Nenet 4, 9-12.
- 8 Ligji nr.10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Neni 3.
- 9 Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.1503, datë19.11.2008, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara””, Neni 26.

*Të gjitha fotot janë bërë nga autorja, përveç atyre të specifikuara ndryshe.

